



REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIK OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAÇKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në pajtim me nenin 4.1.14 te Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenin 7 paragrafi 1.5 të Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit, miraton në vijim:

RREGULLORE MBI MANDATIN, STRUKTURËN DHE FUNKSIONIMIN E ZYRËS PËR MBROJTJE DHE NDIHMË VIKTIMAVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mandati, funksionimi dhe struktura e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.

Neni 2 Përkufizimet

- Mbrojtës i viktimave**— Përfaqësuesi i autorizuar i cili ka kompetencë për: ta njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e tij/saj, dhe përfaqësimin e interesave të viktímës në procedurën në prokurori dhe gjykatë; dhe kur është e nevojshme, e referon viktímën tek ofruesit tjerë të shërbimeve. Mbrojtësi i viktimave vepron në emër të viktímës kur është e nevojshme, dhe e duhur për ta ndaluar shkeljen e të drejtave të viktímës dhe për të kërkuar veprim për garantimin e mbrojtjes së tyre.
- Linjë ndihmëse-është** numër telefonik publik dhe pa pagesë për t'ua mundësuar viktimave dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit; për informimin e viktimave dhe personave tjerë lidhur me të drejtat e tyre, sigurimin e informatave të nevojshme për shërbimet ekzistuese dhe numrat kontaktues.
- Viktimë**- personi fizik të cilit iu është shkaktuar dëm, përfshirë dëmin fizik, mendor apo emocional apo humbje ekonomike të shkaktuar drejtpërsëdrejti nga vepra penale. Termi viktimë gjithashtu përfshinë në raste të caktuar edhe anëtarin e familjes apo mvartësit e

viktimës së drejtpërdrejtë, siç definoohen me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

4. **Raste me prioritet:** Kategoritë e veprave penale, siç janë përcaktuar nga kryeprokurori i shtetit, që duhet të marrin mbrojtje me prioritet. Aktualisht, këto përfshijnë viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimit seksual dhe vrasjes.
5. **Kujdestaria:** statusi i punës i mbrojtësit të viktimate që kërkon nga mbrojtësi i viktimate që të jetë në dispozicion 24 orë në ditë për të ofruar ndihmë për viktimat në pajtim me këto procedura standarde të veprimit.
6. **Rast i hapur:** rasti në të cilin ZMNV-ja apo mbrojtësi i viktimate e përfaqëson viktimën e krimít.
7. **Raporti ditor i incidentit (RDI):** Dokument që përgatitet nga policia për ta informuar menagjmentin policor dhe agjencitë tjera lidhur me aktivitetin kriminal në një rajon të caktuar për çdo ditë.

KAPITULLI II ROLI DHE STRUKTURA E ZMNV-SË

Neni 3 Mandati i Zyrës

1. Shteti e ka për obligim që t'i mbrojë të drejtat e njeriut të popullatës së saj. Ndjekja e rasteve penale është përgjegjësi e shtetit. Të drejtat të viktimate dhe kryerësve janë çështje të rëndësishme që duhet të merren në konsideratë nga sistemi gjyqësor. Shteti duhet të sigurojë që të drejtat e njeriut të mos harrohen gjatë procedurave penale.
2. ZMNV është vendosur në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit. Kryeprokurori i shtetit ka përgjegjësi primare për të siguruar drejtësi në çështjet penale. ZMNV-ja e ka për obligim që të sigurojë mbrojtje të të drejtave të viktimate në sistemin e drejtësisë. Ky obligim ekziston kryesisht gjatë procedurës së hetimeve, ndjekjes dhe dënimit të një kryerësi. Ky obligim i përfshinë edhe rastet ku shteti, përmes gjykatës mund t'i kufizojë të drejtat dhe privilegjet e kryerësit si rezultat i një urdhri për mbrojtje.
3. ZMNV identifikon resurset për të plotësuar nevojat e viktimate të krimít dhe për të nxitur rehabilitimin e tyre. ZMNV identifikon mangesitë në shërbime dhe punon në bashkëpunim dhe koordinim me ofruesit e tjerë të shërbimeve për të plotësuar sa më mirë nevojat e viktimate në bazë të ligjit në fuqi.

Neni 4 Struktura e zyrës

1. ZMNV është zyrë e pavarur brenda Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit. ZMNV është përgjegjëse për të siguruar që politikat e ZMNV-së të jenë në pajtim me politikat e Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit dhe Këshillit Prokurorial.

2. Zyra e ZMNV-së përbëhet nga zyra qendore, zyret regionale të mbrojtësve të viktimate si dhe zyra e linjës ndihmëse.

3. Zyret regionale të Mbrotësve të viktimate janë të vendosura në 7 rajone brenda Republikës së Kosovës:

3.1 Prishtinë

3.2 Ferizaj

3.3 Mitrovicë

3.4 Prizren

3.5 Gjakovë

3.6 Pejë dhe

3.7 Gjilan.

**Neni 5
Kriteret**

1. Mbrotësit e viktimate kërkohen që ta kenë të kryer fakultetin juridik.
2. Zyrtarët e ZMNV që nuk i plotësojnë kriteret nga paragrafi (1) të këtij nenit, përjashtohen nga ato kritere duke lënë të kuptohet që këto kritere do të plotësohen brenda 3 viteve nga data kur ky dokument hyn në fuqi.
3. Këshilli Prokurorial i Kosovës në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës harton planprogramin specifik për trajnimin e mbrotësve të viktimate.

**Neni 6
Detyrat e menagjerit të ZMNV**

Menagjeri i ZMNV-së është përgjegjës për menaxhim efektiv të burimeve dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga kryeprokurori i shtetit.

**Neni 7
Detyrat e kordinatorit të ZMNV**

Nën mbikqyrjen e drejtpërdrejt të menagjerit të ZMNV, kordinatori i ZMNV-së është përgjegjës për koordinimin dhe mbikqyrjen e punës së Mbrotësve të Viktimate duke iu ofruar këshilla dhe udhëzime të nevojshme për të siguruar bashkëpunim në mes të zyreve rajonale dhe zyres qendore të ZMNV.

Neni 8
Detyrat e mbrojtësit të viktimave

1. Çdo zyre rjonale të mbrojtësve të viktimave ka një Mbikëqyrës , i cili kordinon punën e mbrojtësve të viktimave në atë rajon dhe raporton përmes kordinatorit të ZMVN në zyrën qendrore të ZMVN.
2. Detyra kryesore e mbrojtësit të viktimave është që t'i mbrojë të drejtat e viktimës së krimtit në sistemin e drejtësisë.
3. Mbrojtësi i viktimave ndërhyr në emër të viktimës, për t'i mbrojtur të drejtat e viktimës gjatë procedurës së hetimit, ndjekjes dhe dënimit të një rasti penal.
4. Mbrojtësi i viktimave i ndihmon viktimat e krimtit për të kërkuar mbrojtje nga shteti. Kjo përfshinë parashtrimin e kërkeseve për urdhra mbrojtës, masa hetimore dhe intervenim të gjykatës për t'i ruajtur interesat e viktimës në çështjet që dalin nga vepra penale.
5. Mbrojtësi i viktimave i këshillon viktimat e krimtit për të drejtat e tyre.
6. Mbrojtësi i viktimave i këshillon viktimat e krimtit për shërbimet shtetërore në dispozicion, i udhëzon viktimat tek autoriteti i duhur për t'i pranuar ato shërbime dhe ndihmon në bashkërendimin e atyre aktivitatave.
7. Mbrojtësi i viktimave i informon dhe sensibilizon akterët shtetëror dhe publikun përkitazime të drejtat e viktimave.

Neni 9
Detyrat e operatorit të linjës ndihmëse

1. Linja ndihmëse është linjë publike pa pagesë në kuadër të ZMVN-së, e cila ka përdetyrë të ofrojë informata, këshilla dhe udhëzime për viktimat dhe personat tjera të interesuar si dhe referim të rasteve tek institucionet përkatëse.
2. Linja ndihmëse ofron mundësin për qytetarët dhe për viktimat që t'i raportojnë krimet.
3. Numri telefonik i linjës ndihmëse është pa pagesë për të gjithë personat që thërrasin në këtë numër.
 - 3.1 Informatat që jepen në linjën ndihmëse janë konfidenciale dhe operatorët e linjës ndihmëse e kanë për obligim që ta ruajnë fshehtësinë e informatave.
4. Detyrat e operatorit të linjës ndihmëse:

4.1 Pranimi i informatave:

- i. Operatori i linjës ndihmëse pranon informatat e ofruara nga thirrësi;
- ii. Operatori i linjës ndihmëse regjistron të gjitha thirrjet dhe informatat e pranuara nga thirrësi.

4.2 Ofrimi i informatave:

- i. Personave të cilët thërrasin në linjën ndihmëse u ofrohen informata për të ndihmuar në identifikimin e llojeve të ndryshme të abuzimeve. Kjo informatë mund t'iu sigurohet personave të ndryshëm, përfshirë por duke mos u kufizuar në viktimat e krimit, viktimat e supozuara apo potenciale, mediave, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të, dhe qytetarët në përgjithësi.
- ii. Sipas nevojës ofron këshillim për personat e interesuar;
- iii. Jep udhëzime të nevojshme për siguri të viktimës dhe viktimate potenciale;
- iv. Personave që telefonojnë në linjën ndihmëse u japid informata dhe numrat e nevojshëm kontaktues.

4.3 Referimi:

- i. Kur personi kërkon ndihmë, operatori i linjës ndihmëse e referon thirrjen Policisë së Kosovës për ofrimin e ndihmës së mëtutjeshme.
- ii. Referimi i rastit do të përfshijë të gjitha informatat e pranuara dhe sipas nevojës të udhëzojë edhe angazhimin e shërbimeve tjera si psh. ambulancës dhe/apo shërbimin e zjarrfikësve, etj.
- iii. Operatori do të regjistrojë të gjitha referimet e bëra në institucionet apo agjencitë tjera.

4.4 Operimi i linjës ndihmëse:

- i. Linja ndihmëse funksionon 24 orë në ditë gjatë 7 ditëve të javës.
- ii. Linja ndihmëse mund të angazhojë studentë praktikant nga universitetet e Kosovës.

4.5 Doracaku i linjës ndihmëse, baza e të dhënavës dhe formulari për raportim tremujor shërbejnë si shtojcë e këtij dokumenti.

Neni 10 Vlerësimi i performancës

1. Vlerësimi i performancës për secilin mbrojtës të viktimate dhe zyrtar tjerë të ZMNV-sëbëhet për çdo vit nga menagjmenti i ZMNV-së, në pajtim me ligjin për shërbimin civil.
2. Menagjmenti i ZMNV-së mund të kërkojë nga Kryeprokurori i regjionit përkatës komente me shkrim mbi punën e mbrojtësit të viktimate që punon në atë regjion.
3. Përshtatshmërisht, menagjmenti i ZMNV-së do t'i përfshijë komentet në vlerësimet e performancës së secilit mbrojtës të viktimate.
4. Vlerësimi i performancës për menaxherin e ZMNV-së bëhet nga Kryeprokurori i Shtetit .
5. Veprimet disiplinore i raportohen Komisionit Disiplinor brenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

**Neni 11
Inspektimet**

1. Menagjimenti i ZMNV do të bëjë inspektime periodike të zyrave rajonale të mbrojtësve të viktimave.
2. Inspektimi përfshinë por nuk kufizohet në:
 - 2.1 Inspektim të dosjeve;
 - 2.2 Pjesëmarrje në seanca të intervistimit të viktimave apo seanca tjera gjyqësore, etj.

**Neni 12
Ankesat ndaj shërbimeve të mbrojtësve të viktimave**

Në rastet kur viktima është e pakënaqur me përfaqësimin nga mbrojtësi i viktimave, ai/ajo ka të drejtë të paraqes ankesën pranë zyres qendrore të ZMNV-së.

**KAPITULLI III
ORGANIZIMI IPUNËS SË ZMNV**

**Neni 13
Caktimi i rasteve**

1. Rastet i caktohen mbrojtësve të viktimave sipas rajonit në të cilin ka ndodhur vepra.
2. Kurdo që është e mundshme, rasti i caktohet mbrojtësit të viktimave i cili ka asistuar në atë rast.
3. Nëse rasti kërkon ndihmë të menjëherëshme nga mbrojtësi i viktimave ai rast mund t'i caktohet mbrojtësit të viktimave i cili është kujdestar.

**Neni 14
Përjashtimet**

1. Në rastet kur viktima e ka një rast të hapur, përfaqësimi i viktimës në rastin e ri do të bëhet nga mbrojtësi i viktimave i cili është caktuar për rastin e hapur.
2. Në rastet kur mbrojtësi i viktimave është i rrezikuar apo i kërcënuar nga kryesi , atëherë menagjimenti i ZMNV-së shqyrton nevojën për caktimin enjë mbrojtësi të viktimave nga regjioni tjetër. Kërcënimi ndaj mbrojtësit të viktimave duhet raportuar në pajtim me procedurat e përcaktuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

3. Ashtu siç përcaktohet nga menagjmenti i ZMVN-së.
4. Caktimi i rasteve koordinohet nga secila zyrë rajonale e mbrojtësve të viktimave.
5. Mbrojtësi i viktimave është përgjegjës për raportimin lidhur me rastet e caktuara te menagjmenti i ZMVN-së.
6. Menagjmenti i ZMVN-së është përgjegjës për monitorimin e ngarkesës me punë të secilit mbrojtës të viktimave dhe për rregullimin e rrotacionit të caktimit të rasteve për të siguruar shpërndarje të barabartë të punës ndërmjet mbrojtësve të viktimave.
7. Si pjesë e monitorimit të ngarkesës me punë për secilin mbrojtës të viktimave, menagjmenti do ta merr parasysh:
 - 7.1 Natyrën e rasteve;
 - 7.2 Cilësinë e reagimit;
 - 7.3 Numrin e rasteve;
 - 7.4 Kualifikimet e një mbrojtësi të caktuar të viktimave dhe
 - 7.5 Rethanat tjera relevante

Neni 15
Delegimi i rasteve

1. Kur një zyre regionale ka mungesë të të burimeve të nevojshme, ajo kërkon ndihmë nga zyra kryesore në Prishtinë, për të deleguar mbrojtës të viktimave nga një rajon tjetër, kurdo që është e mundshme.
2. Rastet duhet të delegohen nga njëra zyre regionale në tjetrën nëse viktima ka ndërruar vendqëndrimin.

Neni 16
Ruajtja e lëndëve

1. Regjistrimi dhe ruajtja e lëndëve nga mbrojtësit e viktimave bëhet në pajtueshmëri me rregulloren e përcaktuar nga KPK.
2. Lëndët duhet të ruhen në kopje të shkruar dhe elektronike. Kopja elektronike duhet të mbahet nga Mbrojtësi i viktimave për nevojën e tij.
3. Lëndët ruhen ndaras përpersonat të mitur dhe personat madhor.

Neni 17
Raportimi

1. ZMNV ka për obligim që t'i respektojë rregullat e Këshillit Prokurorial të Kosovës për raportim.
2. ZMNV harton raporte të rregullta, tremujore dhe vjetore.
3. MV harton raporte javore:
 - 3.1 Raportet javore përfshijnë emrin e MV-së, rajonin ku është caktuar, numrin e rasteve të reja për atë javë, një pasqyrim të secilit rast të ri, paraqitjet në gjykatë, numrin dhe natyrën e parashtresave në gjykatë, numrin e urdhreve mbrojtës të kërkuar, dhe pjesëmarrjen në trajnime. Formulari 2 i bashkëngjiten raporteve javore.
 - 3.2 Formulari 1 dhe 3 përdoret për menaxhim të rasteve dhe në ruhen dosjen e rastit
 - 3.3 Raportet javore i dorëzohen menagjmentit të ZMNV-së për raportim, informim dhe rishikim.
4. Mbrojtësi i viktimate i dokumenton kontaktet/tentimet për kontaktim dhe veprimet e ndërmarra/shërbimet për secilin rast.

Neni 18
Ankesat për shërbimet e ofruara nga institucionet apo ofrues tjerë të shërbimeve

1. Në rast se mbrojtësi i viktimate e identifikon një mangësi në shërbimet e ofruara nga ndonjë institucion tjetër shtetëror e që ka pasur ndikim negativ në mbrojtjen e të drejtave të viktimës, mbrojtësi i viktimate i paraqet raport me shkrim menagjmentit të ZMNV-së lidhur me natyrën e asaj mangësie.
2. Menagjmenti i ZMNV-së komunikon me autoritetet përkatëse për t'i korrigjuar shkeljet e të drejtave të viktimës.
3. Mbrojtësi i viktimate e udhëzon viktimin tek autoriteti i duhur për të bërë ankesë formale lidhur me ofruesin e shërbimit.

KAPITULLI IV
KODI I ETIKËS

Neni 19
Statusi i zyrtarëve të ZMNV

Punonjësit e ZMNV-së janë shërbyes civil dhe si të tillë obligohen nga kodi i etikës së shërbyesve civil, kodi i etikës së punonjësve mbështetës të sistemit prokurorial. Për shkak të specifikave të veçanta të punës së tyre, mbrojtësit e viktimate duhet tu përbahen edhe disa standardeve të veçanta nga nenii 20 i këtij dokumenti.

Neni 20
Standardet e veçanta etike për anëtarët e ZMNV-së

1. Përkushtimi ndaj viktimate:

- 1.1. Mbrojtësit e viktimate duhet t'iu shërbejnë të gjitha viktimate me përkushtim, besueshmëri dhe vendosmëri, me kompetencë dhe shkathtësi profesionale.
- 1.2. Mbrojtësit e viktimate duhet të sillen në mënyrë të sinqertë dhe të besueshme.
- 1.3. Mbrojtësit e viktimate duhet t'i sqarojnë dhe të sigurojnë informata të plota dhe të sakta lidhur me shërbimet që janë në dispozicion për viktimat.

2. Mosdiskriminimi:

- 2.1 Mbrojtësit e viktimate e respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e të gjitha viktimate.
- 2.2 Mbrojtësit e viktimate nuk duhet të diskriminojnë mbi bazë të racës, nacionalitetit, gjinisë, orientimit seksual, moshës, statusit martesor etj.

3. E drejta e viktimës për vëtpërcaktim:

- 3.1 Mbrojtësi i viktimate nuk do ta imponojë gjykimin e tij/saj tek viktima, përfshirë të drejtën e viktimës për t'i refuzuar shërbimet në çfarëdo kohe pavarësisht nga situata.
- 3.2 Mbrojtësi i viktimate nuk i bënë presion viktimës për pranimin e shërbimeve.

4. Fshehtësia (konfidencialiteti) e informatave personale të viktimës:

- 4.1 Mbrojtësi i viktimate duhet ta respektojë privatësinë e viktimës dhe t'i mbajë të fshehta të gjitha informatat e pranuara gjatë dhënies së shërbimit profesional.
- 4.2 Mbrojtësit e viktimate nuk duhet t'i ndajnë informatat personale të klientëve me ata të cilët nuk kanë as leje të duhur e as nevojë për t'i ditur ato.
- 4.3 Mbrojtësit e viktimate kanë përgjegjësi për t'i informuar viktimat lidhur me kufizimet e fshehtësisë së informatave në ndonjë situatë të caktuar, arsyet e marrjes së informatave specifike dhe mënyrën se si do të përdoren ato.

5. Premtimet për viktimën:

- 5.1 Mbrojtësit e viktimate nuk duhet të japid kurrrfarë garancie lidhur me përfundimet ligjore apo kompensimin financiar.

6. Konflikti i interesit:

6.1 Standardi:

- i. Mbrojtësi i viktimave nuk e përfaqëson viktiminë nëse përfaqësimi përfshinë konflikt të njëkohshëm të interesit apo konflikt të paraparë në dispozitat e nenit 45 paragrafit 3 të KPP-së.
- ii. Konflikti i njëkohshëm i interesit ekziston kur:
- iii. përfaqësimi i një viktime do të jetë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me një viktimi tjetër, apo
- iv. ekziston rrezik i shprehur që përfaqësimi i një apo më shumë viktimave do të jetë i kufizuar në masë thelbësore nga përgjegjësitë që mbrojtësi i ka ndaj një viktime tjetër, ish viktime, apo personi tjetër, apo nga interesi personal i mbrojtësit.

6.2 Në rast të konfliktit të interesit si ai i paraparë më lartë në paragrafin 6.1 të këtij neni, Mbrojtësi i viktimave do t'i respektojë procedurat e renditura më poshtë:

- i. Nëse ekziston ndonjë konflikt i interesit ndërmjet dy viktimave, mbrojtësi i viktimave duhet të veprojë në mënyrën më të mirë në emër të njës viktimë, vetëm pasi ta ketë referuar viktiminë tjetër te mbrojtësi tjetër i kualifikuar i viktimave, për t'i pranuar shërbimet.
- 6.1 Mbrojtësi i viktimave siguron informata të plota dhe të sakta lidhur me rastin kur ta referojë atë te një mbrojtës tjetër i kualifikuar.
- 6.2 Në rast se viktima bëhet i/e akuzuar përmes kryerjes së një vepre penale kundër personit ndaj të cilit viktima ka bërë pretendime penale, atëherë statusi i atij personi ndryshon nga viktima në të pandehur. Në raste të tilla, viktima, tanë i pandehuri, nuk ka më të drejtë që t'i pranojë shërbimet e ZMNV-së.

7. Kompetenca profesionale

- 7.1 Mbrojtësi i viktimave duhet të mëtojë të bëhet dhe të mbetet ekspert në praktikën profesionale dhe kryerjen e funksioneve profesionale.
- 7.2 Mbrojtësit e viktimave nuk duhet të ofrojnë ndihmë jashtë fushëveprimit të pozitës së tyre.
- 7.3 Mbrojtësit e viktimave nuk duhet ta marrin si të vetën njohurinë që e kanë fituar nga një burim tjetër; dhe mbrojtësit e viktimave nuk duhet t'i shtrembërojnë informatat që i jepen një viktime.
- 7.4 Mbrojtësit e viktimave duhet të janë në dijeni dhe të kenë njohuri për kulturat e ndryshme që do t'i hasin dhe mënyrën se si të bashkëveprojnë me viktimat nga kulturat tjera.
- 7.5 Roli dhe kompetenca e mbrojtësit të viktimave në procedurë penale janë përkufizuar dhe kufizuar në bazë të KPP-së.
- 7.6 Mbrojtësi i viktimave nuk mund të kryejë asnjë veprim në emër të viktimës nëse ai veprim mund ta pengojë procesin gjyqësor apo ta rrezikoj hetimin, arrestimin apo ndjekjen e të dyshuarit.

Neni 21
Procedurat standarde të Veprimit

1. Kryeprokurori i Shtetit do të lëshojë udhëzim të detyrueshëm mbi procedurat standarde të veprimit lidhur me zbatimin e kësaj Rregullore dhe dispozitave të aplikueshme ligjore mbi mbrojtjen efikase të të drejtave të viktimateve të krimít.
2. Prosedurat standarde te veprimit do te jenë të obligueshme për zbatim nga të gjithë personeli i ZMNV dhe prokurorët e shtetit.

Neni 22
Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullorës

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën dhe procedurën e njëjtë me të cilën është nxjerr.


Neni 23

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Miratuar me datë ____/____/2013

Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës


Ismet Kabashi

